



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 73-të të mbajtur më 18.08.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Kërkesa e regjistruar me numrin 12-3692/1 të datës 13.04.2022, kundër personit -----
-----, gjyqtar në Gjykatën Themelore -----, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme lidhur me lëndën, për rastin në fjalë procedurat janë duke u zhvilluar pranë organeve tjera kompetente.

Lënda me numër 12-3692 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga ana e parashtruesit të njohur ----- SHPKNJP nga Shkupi me datë 13.04.2022 është dorëzuar denoncim për personin ----- gjyqtar në Gjykatën Themelore. ----- sipas së cilës është formuar lënda me numër 12-3692 të vitit 2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se gjyqtari në fjalë ----- me veprimet e tij në çështjet gjyqësore P1 nr.--/19 dhe VPP.2.nr.--/21 të zhvilluara në Gjykatën Themelore ---- -, le dyshime për korrupsion në mes saj dhe palëve në procedurën në fjalë.

Procedurat e cekura janë zhvilluar me qëllim të përcaktimit të së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme të regjistruar në Listën pronësore ----- KK Veles të PK-së nr. -----/1.

Të pakënaqur me Aktgjykimin e miratuar me nr. P1----/19 parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit ku u mor vendim për ndryshimin e aktgjykimit në fjalë nga Gjykata e Shkallës së Parë -----, por parashtruesi që mori pjesë në procedurën gjyqësore nuk është informuar për këtë një ndërhyrës nga ana e të pandehurit, për të cilën më vonë janë paraqitur kërkesa urgjente për dorëzimin e vendimit.

Po ashtu, parashtruesi thekson se lidhur me keqpërdorimet e gjyqtarit të denoncuar, është parashtruar kallëzim penal në Prokurorinë Publike -----, duke përfshirë persona të tjerë fizikë dhe juridikë, pjesëmarrës në procedurë.

Po ashtu, thuhet se është dorëzuar Kërkesë për përcaktimin e përgjegjesisë së gjyqtarit para Këshillit Gjyqësor të RMV-së, si dhe kërkesë për kryerjen e kontrollit të jashtëzakonshëm deri te kryetari i Gjykatës së Apelit Shkup, nga ku tashmë kanë marrë njoftim se lëshimet që kishin treguar në kërkesë janë konstatuar.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve, KSHPK-ja i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të RMV-së me kërkesë për informim nëse është ngritur rast kundër gjyqtarit të përmendur dhe për veprimet e tyre kompetente në lidhje me pretendimet.

KSHPK-së i është dorëzuar një përgjigje, ku thuhet se Këshilli Gjyqësor i RMV-së në kuadër të kompetencave të tij, duke vepruar sipas kërkesës për përcaktimin e përgjegjesisë së gjyqtarit ----- nga gjykata themelore -----, ka krijuar lëndë dhe procedura për të është në vazhdim e sipër.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK-ja konstaton se në rastin bëhet fjalë për pretendime që nuk i nënshtrohen veprimit të saj kompetent, por janë pretendime që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, për arsye se për lëndën në fjalë zhvillohen procedura para organeve tjera kompetente.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr. K.Z.
Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK - së

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЕ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ

Kryetare,
Biljana Ivanovska

